- Në bazë të kontratës Depo Importuese/Distributore____”, duhet të na ktheni 1 (një) kopje të nënshkruar, së bashku me vërejtjet përkatëse nëse do te keni, brenda (shifër dhe fjalë) diteve nga data e marrjes së këtij procesverbalit.

Nëse nuk paraqisni dokumente apo prova të reja dhe nuk ktheni përgjigje në afat, problemet e trajtuara në procesverbal konsiderohen të mirëqena.

Emri mbiemri i personit
Përgjegjës

Specialistët e DKPF

1. _____
2. _____
Etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Drejtoria e Kontrollit Parësor dhe Farmaceutik

Nr._____.Prot.

Tiranë, më ___/___/_____

RAPORT KONTROLLI

(Gërma kapitale,numër 14, bold)

I përgatitur më datë_____ nga specialistet e kontrollit të Fondit *(specialistet sipas programit të kontrollit)*, mbi kontrollin e ushtruar ne depot farmaceutike me kontrate me Fondin/DRF-___ me objekt: “Mbi *(shënohet objekti i kontrollit sipas programit)*”.)

Kontrolli u krye nga data ___ deri më datën ___*(shënohen datat kur fillon dhe mbaron kontrolli në subjekt sipas përcaktimit në program)*, sipas drejtimeve të përcaktuara në Programin e Kontrollit nr.____ datë ___, të miratuar nga Titullari i Fondit për periudhën e kontrollit nga ___, deri ___*(shënohet periudha e kontrolluar sipas programit të kontrollit)*.

Gjatë kontrollit të kryer për *(zbatimin e detyrimeve kontraktuale, apo me inventarizim)*,ne subjektet me kontrate me Fondin/DRF-___ u verifikua sipas rastit dokumentacioni (e plotë apo me zgjedhje) që ju vu në dispozicion grupit të kontrollit

Përsa më sipër, me personat përkatës në *(emërtimi i subjektit të kontrolluar)* u mbajtën aktverifikime, apo procesverbale *(sipas përkatësisë)*, kopjet e të cilave ju lanë në vend këtyre personave. Në përfundim, pasi u shqyrtuan vërejtjet dhe shpjegimet e personave përgjegjës, paraqitur me date _____ ne Fond, janë marrë në konsideratë ato që kishin argumentim e mbështetje ligjore, ju paraqitet ky Raport Kontrolli.

Në vijim, *(trajtohen me rradhë të gjitha pikat e kontrolluara në përputhje me përcaktimin e bërë në Programin e Kontrollit)*, më konkretisht:

1...*Sipas tematikës së programit të kontrollit (emërtimi)...., më pas vijohet me shtjellimin. Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara cilësohet dispozita ligjore e shkelur, personat shkaktarë përgjegjës, funksioni, dëmi ekonomik etj.*

2...*E njëjta gjë si në pikën e parë.....,*

3...*Dhe kështu me rradhë, pikat në tematikën e programit, dhe më pas shtjellimi.*

Në secilën pikë të tematikës së kontrollit të shtjelluar, duhet të bëhen edhe sqarimet për vërejtjet e bëra nga punonjësit e kontrolluar duke cilësuar që: – *këto apo ato vërejtje janë marrë parasysh nga vërejtjet e bëra për procesverbalin apo aktverifikimin dhe këto nuk janë marrë parasysh, këto të fundit duhet të argumentohen ligjërisht për pabazueshmërinë e tyre (duke shkruajtur dispozitën përkatëse ligjore apo nënligjore).*

Të gjithë subjekteve që janë trajtuar në këtë Raport kontrolli, duhet që me parë t'u jene bërë prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, nepermjet kopjeve të akt-verifikimeve, akt-rakordimeve dhe procesverbaleve apo çdo dokument tjetër kontrolli.

Ne pjesën përmblylëse të raportit të shkruhet:

- Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave të mëposhtme:

- duke renditur një për një masat që i lihen për zbatim subjektit të kontrollit, në zbatim të kontratës, e që janë masa administrative (gjoba) dhe masa zhvenditimi, masa organizative apo « Nderprerje kontrate », etj.

Në mbyllje të raportit të cilësohet:

Përsa më sipër paraqiten rekomandimet dhe masat

Pjesë përbërëse e këtij Raporti kontrolli janë edhe dokumentacioni i mbajtur, si më poshtë:

7. Procesverbali nr. 1, për.....
8. Procesverbali nr. 2, për.....*dhe me rradhë.*
9. Aktverifikimi nr. 1, për.....
10. Aktverifikimi nr. 2, për*dhe me rradhë.*
11. Akt-rakordimi nr. 1, periudha;
12. Akt-rakordimi nr. 2, periudha.

Në fund të raportit shkruhet:

Specialistet e Fondit

1. _____

2. _____

dhe me rradhë.

(Gërma kapitale, numri 14, bold, emrat jo me gërma kapitale, vetëm mbiemrat)

Drejtori i Drejtorisë të Kontrollit Parësor dhe Farmaceutik

Emër Mbiemër



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Drejtoria e Kontrollit Parësor dhe Farmaceutik

Nr. ____ .Prot.

Tiranë, më __/__/____

V E N D I M *(shkrimi 16, bold)*

Nr. ____, Datë _____

MBI: KONTROLLIN E USHTRUAR NË DEPOT FARMACEUTIKE ME KONTRATË ME FONDIN APO DRF _____

Zotit _____

Drejtori i Drejtorise Rajonale.

Drjtoria e Burimeve Njerëzore (Sektori i Financës së Brendëshme)

Drejtoria e Cmimeve dhe Rimbursimit të Barnave

(Sektori Kontratimeve)

DRJTUES TEKNIK /PRONAR /ADMINISTRATOR

(në varësi të depos farmaceutike ku ka lidhur kontratën)

Vendndodhja - **Adresa** *(e vizuar)*

(me gërma kapitale, numër 14, bold).

_____*(emri i rrethit)*

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Kontrollit, të paraqitur nga grupi i kontrollit të Drejtorisë së Kontrollit Paresor dhe Farmaceutik të Fondit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i kontrolluar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e kontrollit nga Drejtori i Drejtorisë së mësipërme, në mbështetje të Ligjit nr. 10383, dt. 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S A: *(numër 16, bold)*

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Kontrollit “Për ..objekti i kontrollit i plotë” të ushtruar në*(emërtimi i subjektit të kontrolluar)*.

II. Të miratoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ZHDËMTIMI

Bazuar në kontratën Depo Importuese/Distributore __ dhe Kapitulli “__” pika __, propozojme masë zhdëmtimi si më poshtë:

Për Depo “_____” me drejtuese teknike Znj. _____, në vlerën _____ **leke (dhe me fjale)**.

pasi nga kontrolli me inventarizim kanë rezultuar me diferenca në plus për disa barna me rimbursim, sipas procesverbalit përfundimtar të mbajtur me subjektin.

-Menjëherë-

Fondi/DRF_____

Këto masa të jenë me afate, ose në varësi të gjykimit të shënohet “Menjëherë”.

B. MASA ADMINISTRATIVE

Bazuar në Kontratën Depo Importuese/Distributore __, Kapitulli “__”, pika __, propozojme masë administrative gjorbë si më poshtë:

-Për Depo “_____” me drejtues teknik Z.Znj. _____ në vlerën _____ **lekë (dhe me fjale)**.

pasi nga kontrolli me inventarizim rezultojnë diferenca në minus të pajustificuara, (ose parregullsi në dokumetacion sipas rastit), sipas procesverbalit përfundimtar të mbajtur me subjektin.

-Menjëherë-

Fondi/DRF_____

C. ZGHIDHJE KONTRATE

Bazuar në Kontraten Depo Importuese/Distributore ____, Kapitulli “_____”, pika __, propozojme të merret masa zgjidhje kontrate për një periudhë _____ (sipas rastit) nga data e njoftimit për:

2. Depo “_____” me drejtuese teknike Znj./Z. _____,

pasi nga kontrolli i ushtruar rezultojnë: “shënohet shkeljet e konstatuara që përbejnë objekt ndërprerje kontrate”, sipas procesverbaleve përfundimtare të mbajtura me secilin subjektet.

-Menjehere-

Fondi/DRF_____

Për masat e marra të njoftohet me shkrim Drejtoria e Kontrollit Parësor dhe Farmaceutik e Fondit, ***brenda 20 ditëve*** nga marrja e kësaj kërkesë.

TITULLARI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Drejtoria e Kontrollit Parësor dhe Farmaceutik

Nr. _____ .Prot.

Tiranë, më __/__/____

VLERËSIMI I CILËSISË SË KONTROLLIT

Subjekti i kontrolluar: _____

Lloji i kontrollit _____

Grupi i kontrollit _____

Afati i kontrollit në ditë pune (Plan) _____

Afati i kontrollit në ditë pune (Fakt) _____

Realizimi i detyrave të Programit të Kontrollit _____

Çështjet e lëna pa kontrolluar nga Programi _____

Evidenca e kontrollit e plotësuar _____

Qartësia dhe konciziteti i raportimit të kontrollit _____

Zbatimi i standarteve të kontrollit _____

Zbatimi i kodit etik _____

Argumentimi ligjor i shkeljeve _____

Konstatimet e dëmeve gjithsej në vlerë _____

Rekomanduar për t'u arkëtuar _____

Arkëtuar gjatë procesit të kontrollit _____

Ballafaqimet e kryera _____

Masat e zhdëmtimit të propozuara në vlerë _____

Masat administrative të propozuara në persona e vlerë _____

Masa disiplinore të propozuara në numër _____

DREJTORI I DREJTORISE

EVIDENCE E KONTROLLIT

KONTROLLET NË DEPO PËR PERIU DHËN

___/___/___ DERI ME ___/___/___

Dt.Kontr. vl. Gjob. Vl demit ek. Vl, kushti penal, dt e nderprerje. kont. Grupi i kontroll shënim

Urdhëri i kontrollit Nr ___ datë ___ DRF ___

Emri i farmacise Drejtusi teknik

Dt.Kontr	vl. Gjob	Vl demit ek	Vl, kushti penal,	dt e nderprerje. kont	Grupi i kontroll	shënim
----------	----------	-------------	-------------------	-----------------------	------------------	--------

Evidenca e kontrollit është pasqyrë e të dhënave të kontrollit të hedhura në programin e përgatatur nga specialistet e DIAS në Fond.

DOSJA NR____ (numër i madh)

Viti 200_

TITULLI :

PËR
KONTROLLIN E USHTRUAR NË *(emërtimin e subjektit)* **PËR** *(tematika e kontrollit)*.
(Gërma kapitale, nr. 16, bold)

Afati i ruajtjes_____

Sasia e fletëve_____

Ka filluar më_____

Ka mbaruar më_____

Regjistruar në inventarin e dosjeve
me numër rendor_____

Fletë Inventari

Inventari i Dosjes Nr. _____, i kontrollit të ushtruar në

(Emri i plote i subjektit të kontrolluar)

Periudha e kontrolluar: _____

Lloji i kontrollit : _____.

Afati i kryerjes së kontrollit: _____ .

Nr	Emertimi i shkreses	Nr. _ date	Nr.fleteve
1	Programi i kontrollit		
2	Urdher Kontrolli		
3	Deklarata		
4	Akt-verifikime		
5	Proces- verbale		
6	Aktrakordime		
7	Procesverbali perfundimtar		
8	Konsumi i barnave per reference		
9	Konsumi i barnave sipas periudhave		
10	Inventari sipas periudhave		
11	Shenime		
12	Kopje e dosjes se kontrollit te DRSKSH		
	TOTALI I FAQEVE		

Inventari përfundon me numër rendor _____ .

Grupi i Kontrollit

(Emri, mbiemri i kontrolloreve)

1. 2. 3. 4

Dorëzuesi (Përgjegjësi i Grupit)

Drejtori i Drejtorise

Marrësi në Dorëzim
(Arkivistja)

Tiranë, më ___ / ___ / 200_

(Dokumenti i unifikuar D DU 17)

RREGJISTRI VJETOR

Nr rendor	Nr.dosjes	Subjekti i kontrollur	Lloji i kontrollit	Grupi i kontrollit	Periudha e kontrolluar	Afati i kontrollit	Nr fleteve te dosjes	Pergatiti dosjen
1								
2								
3								

Përgjegjësi i sektorit

Drejtori i Drejtorisë

KAPITULLI IV

PËR KONTROLLIN E SPITALEVE QË FINANCOHEN NGA SKEMA E FONDIT TË SIGURIMEVE TË DETYRUESHME TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

1. Kjo rregullore është e zbatueshme për strukturat e Fondit që kanë kompetenca për kontrollin e spitaleve publike e që janë:

- Drejtoria e Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor
- Drejtoritë Rajonale të Fondit

2. Në rregulloren e kontrollit spitalor në vijim, me termin Drejtor i Drejtorisë do të nënkuptohen drejtorët e këtyre strukturave të Fondit.

3. Spitalet e kontraktuara me Drejtoritë Rajonale të Fondit dhe Drejtorinë Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor, i nënshtrohen kontrollit nga strukturat kontrolluese që funksionojnë në këto drejtori, për zbatimin e detyrimeve kontraktuale në fuqi.

4. Kontrollat në spitale, organizohen të plota dhe tematike:

Kontrulli i plotë kryhet nga:

Drejtoria e Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor, (DSHSUKS) për të gjitha nivelet e spitaleve të kontraktuara nga skema e sigurimeve shëndetësore.

Ky kontroll ushtrohet jo më pak se 1 (një) herë në vit në spitalet universitare dhe spitalet rajonale, dhe jo më pak se 1 herë në 2(dy) vjet në spitalet bashkiakë.

Kontrulli përfshin të gjithë aktivitetin spitalor për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, ligjore dhe nën-ligjore.

Nëpërmjet kontrollit synohet të arrihen konkluzionet e mëposhtme:

- Zbatimi i detyrave të lëna nga kontrollat e mëparëshme;
- Programet dhe objektivat që janë arritur ose do të arrihen;
- Informacioni financiar dhe i drejtimit është i plotë dhe i besueshëm;
- Burimet financiare përkatëse nëse janë përdorur në përputhje me programet dhe rregullat e caktuara në zbatim të legjislacionit në fuqi;
- Dhënia e shërbimit shëndetësor në spital nëse është me standarde dhe sipas detyrimeve të vendosura në kontratë;
- Zbatimi i sistemit të referimit të pacientit;
- zbatimi i përgjegjësive, detyrimeve kontraktuale nga mjeku specialist i spitalit;
- performanca e spitalit nëse është arritur apo jo në përputhje me kontratën;
- zbatimi i detyrimeve për plotësimin e dokumentacionit teknik, njohje dhe zbatimi i rregullores së funksionimit të spitalit, rregullorja e shtrimit në spital, plotësimi i rregjistrave, kartelave klinike si dhe funksionimi i kabineteve në poliklinikë, etj.

Kontrulli tematik kryhet nga:

Drejtoria e Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor për të gjitha nivelet e spitaleve të kontraktuara nga skema e sigurimeve shëndetësore dhe Drejtoritë Rajonale të Fondit për spitalet me të cilat ato kanë kontratë.

Kontrolli tematik realizohet në zbatim të çdo pike të detyrimit kontraktual si dhe zbatimin e detyrave dhe rekomandimeve të lëna nga kontrollet e mëparshme.

5. Plani vjetor i kontrollit përfaqëson dokumentin bazë, sipas të cilit realizohet veprimtaria e Sektoreve të kontrollit spitalor, gjatë vitit ushtrimor. Në planin vjetor përcaktohet emërtimi i spitaleve që kontrollohen sipas muajve dhe llojet e kontrolleve të plota ose tematike. Plani vjetor hartohet nga Drejtori i Drejtorisë dhe duhet të jetë i rakorduar me planin e Ministrisë së Shëndetësisë (Për mos të pasur përplasje gjatë ushtrimit të kontrollit) dhe miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Fondit. Plani vjetor mund të ndryshojë me propozim të argumentuar nga Drejtori i Drejtorisë me miratim të Drejtorit të Përgjithshëm të Fondit.

6. Programi i kontrollit hartohet sipas parashikimeve të planit vjetor të kontrollit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm. Programi i kontrollit miratohet nga Drejtori i Drejtorisë, (DU 1).

7. Pas miratimit të programit të kontrollit specialistët e kontrollit plotësojnë deklaratën e konfliktit të interesit i cili konfirmohet nga Drejtori i Drejtorisë, (DU 2).

Nëse specialisti i grupit të kontrollit deklaron se ka konflikt interesi në spitalin ku do të angazhohet për kontroll, Drejtori i Drejtorisë bën zëvendësimin e tij me një anëtar tjetër.

Nëse rasti që përbën konflikt interesi zbulohet pasi ka filluar kontrolli në subjekt, anëtari që ka konflikt interesi duhet të plotësojë menjëherë një deklaratë të konfliktit të interesit duke pasqyruar rastin konkret dhe t'ia bëjë menjëherë të ditur drejtorit të drejtorisë. Drejtori i Drejtorisë, bën menjëherë zëvendësimin e tij duke bërë një ndryshim në programin e kontrollit dhe vlerëson sipas rastit nëse kontrolli i kryer deri në atë moment nga ky anëtar do të mbetet i vlefshëm apo do të rikryhet nga anëtari zëvendësues.

8. Njoftimi i subjektit bëhet zyrtarisht me shkrim. Ai duhet të jetë i nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë. Njoftimi i dërgohet subjektit 5-10 ditë para fillimit të kontrollit, (DU 3). Kjo procedurë nuk zbatohet vetëm në rastet kur Drejtori i Përgjithshëm i Fondit vlerëson nevojën e kryerjes së një kontrolli të befasishtë sipas një tematike specifike.

9. Përberja e grupit të kontrollit të spitaleve caktohet nga Drejtori i Drejtorisë. Grupi i kontrollit përbehet nga jo më pak se tre specialistë, njëri prej të cilëve është përgjegjës grupi.

10. Në përputhje me detyrat e parashikuara në programin e kontrollit, përgjegjësi i grupit bën ndarjen e detyrave konkrete për çdo specialist të grupit të kontrollit. Ndarja e detyrave miratohet nga drejtori i Drejtorisë. Përmbushja e detyrave për grupin e kontrollit bëhet në përputhje me rregulloren e brendshme funksionale të Drejtorisë.

11. Përgjegjësi i grupit së bashku me grupin e kontrollit bën prezantimin e programit të kontrollit me drejtuesit e subjektit (spitalit) objekt kontrolli mbi kontrollin që ushtrohet sipas periudhës së përcaktuar në program. Ky takim dokumentohet dhe nënshkruhet nga specialistët e kontrollit dhe drejtuesit e spitalit pjesëmarrës në takim, (DU 4).

12. Për të ushtruar kontrollin e veprimtarisë së spitalit, nga grupi i kontrollit do të ndiqen detyrimet kontraktuale sipas kontratave respektive dhe pikat e programit të kontrollit.

Grupi i kontrollit përpara se të fillojë kontrollin e një subjekti duhet të ketë siguruar të dhënat, informacionet si dhe rekomandimet e bëra nga kontrolli i mëparshëm për subjektin që kontrollohet.

13. Për kryerjen e angazhimit, specialistët e kontrollit që janë anëtarë të grupit të punës kanë të drejtën e ekzaminimit të çdo të dhëne, informacioni, dokumenti apo materiali tjetër që lidhet me realizimin e kontrollit, përfshirë informacione të ruajtura në pajisjet elektronike, kopje të tyre, transkriptime, lista shkresa etj. Specialistët e kontrollit respektojnë kuadrin ligjor për mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave dhe të informacionit. Specialistet e kontrollit përgjatë gjithë procesit të kontrollit mbajnë shënime ku regjistrohen detyrat e dhëna nga drejtori ose përgjegjësi i grupit, parregullsitë, shkeljet, abuzimet, shpërdorimet apo gjetjet e tjera, si dhe organizojnë ballafaqime me specialistet e subjektit që kontrollohet për të vlerësuar sa me objektivisht problematikën e konstatuar. Krahas kontrollit të dokumentave, bëhet shqyrtimimi i tyre me metoda e teknika të caktuara me qëllim evidentimin e parregullsive, gabimeve dhe abuzimeve, duke u mbështetur në metodën e sondazhit, të spontimeve ose në të dyja së bashku.

14. Në përfundim të kontrollit për çdo pikë të programit, specialistët e kontrollit mbajnë akt-verifikimet përkatëse me personat përgjegjës të subjektit të kontrolluar, (DU 5). Akt/verifikim është një dokument që shërben për të trajtuar çdo pikë të programit të kontrollit dhe çdo gjetje të argumentuara me bazë ligjore, i cili protokollohet në subjekt dhe është pjesë e dosjes së kontrollit.

15. Në të gjitha rastet, kur gjatë kontrollit konstatohet shkelje të detyrimeve kontraktuale, të procedurave, të rregulloreve apo të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, me personat përgjegjës hartohet procesverbal. Procesverbali mbahet me personat përgjegjës duke e argumentuar shkeljen me bazë ligjore dhe nënshkruhet nga specialistet e grupit të kontrollit dhe nga subjekti. Procesverbalet protokollohen në subjekt dhe janë pjesë e dosjes së kontrollit, (DU 6). (Procesverbali mbahet në të gjitha rastet kur konstatohen dëme ekonomike dhe shkelje të dispozitave ligjore në fuqi).

16. Grupi i kontrollit është i detyruar të marrë në dorëzim me protokoll, kundërshtimet e argumentuara ose observacionet e mundshme që specialistët e subjektit të kontrolluar kanë ndaj akt/verifikimeve ose procesverbaleve të mbajtura gjatë kontrollit.

17. Ditën e fundit të kontrollit, pasi kanë përfunduar të gjitha formalitetet shkresore, mbahet takimi mbyllës nga grupi i kontrollit me drejtuesit e spitalit dhe gjithë personat e atakuar gjatë ushtrimit të kontrollit. Gjatë këtij takimi bëhet prezent mbyllja e programit të kontrollit, gjetjet e konstatuara, si dhe argumentet e subjektit të kontrolluar duke siguruar transparence para hartimit të projekt/raportit, (DU 7).

18. Me përfundimin e takimit përmbyllës grupi i kontrollit përgatit një informacion të shkurtër me shkrim për drejtorin e drejtorisë, me anë të të cilit i raporton gjetjet dhe konkluzionet paraprake të kontrollit. Informacioni është pjesë e dosjes së kontrollit.

19. Në përfundim të kontrollit, grupi i kontrollit harton projekt/raportin e kontrollit në të cilin paraqiten rezultatet paraprake të kontrollit të kryer. Projekt/raportet duhet të përmbajë të dhëna të sakta (Mbështetje në evidenca të mjaftueshme), të jenë objektive (raporte të paanshme dhe pa devijime), të qarta (të ekspozohen problemet sipas një renditje logjike nga të dhënat deri të konkluzionet dhe rekomandimeve përmes fjalive të shkurtra dhe duke shmangur termat teknike) koncize (pa lënë jashtë çfarë është e

domosdoshme), konstruktive (trajtim profesional me tonalitetin e duhur), të plota dhe në kohë. Projekt/raporti është dokumenti i parë përmbledhës i veprimtarisë kontrolluese që i dërgohet Spitalit me një shkresë zyrtare për titullarin e spitalit. Hartohet duke u mbështetur në programin e kontrollit dhe në ekzaminimin e dokumentacionit mbi bazën e gjetjeve dhe vlerësimeve. Çdo specialist kontrolli harton projekt/raportin për pjesën e kontrollit të kryer dhe ia dorëzon përgjegjësit të grupit. Projekt/raporti nënshkruhet nga specialistët e kontrollit, (DU 8).

20. Projekt/raporti i dërgohet subjektit brenda 2 javëve pas përfundimit të kontrollit me një shkresë përcjellëse të Drejtorit të Drejtorisë, (DU 9).

21. Subjekti i kontrolluar ka të drejtën dhe detyrimin që brenda 10 ditëve të kthejë një kopje të projekt raportit të firmosur me ose pa vërejtje për gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura paraprakisht.

22. Drejtori i Drejtorisë merr në shqyrtim vërejtjet dhe observacionet e paraqitura nga subjekti i kontrolluar mbi projekt/raportin dhe pas verifikimeve dhe vlerësimit përkatës kërkon reflektimin e tyre në raportin e kontrollit.

23. Raporti i kontrollit hartohet brenda 10 ditëve nga data e kthimit të projekt/raportit nga subjekti i kontrolluar, nga përgjegjësi i grupit të kontrollit në bashkëpunim me grupin e kontrollit dhe nënshkruhet nga ata. Raporti i kontrollit hartohet me të njëjtën strukturë që ka projekt/raporti i kontrollit.

24. Drejtori i Drejtorisë merr vendimin për miratimin e Raportit të Kontrollit dhe bazuar në raportin e Kontrollit vendos për masat organizative, zhdëmtuese, administrative, disiplinore etj., ndaj subjektit të kontrolluar. Një kopje e vendimit i dërgohet Drejtorit të Përgjithshëm të Fondit, (DU 10).

25. Raporti i kontrollit dhe vendimi i drejtorit të drejtorisë i dërgohet subjektit të kontrolluar brenda 10 ditëve nga kthimi i projekt raportit të kontrollit nga subjekti i kontrolluar.

26. Pas çdo kontrolli përgjegjësi i grupit harton evidencën e rezultateve të kontrollit sipas rekomandimeve të bëra nga çdo specialist ku përcaktohen masat administrative, organizative dhe zhdëmtuese, (DU 11).

27. Pas çdo kontrolli Drejtori i Drejtorisë bën vlerësimin e cilësisë së kontrollit ku vlerëson kontrollin e realizuar në zbatim të bazës ligjore, (DU 12).

28. Pas përfundimit të kontrollit dhe dërgimit nga subjekti të masave të marra për rekomandimet e dërguara, përgjegjësi i grupit, në bashkëpunim me grupin e kontrollit përmblyll dosjen dhe bën inventarizimin e dokumentacionit të dosjes, (DU 13).

29. Dosja e përfunduar dhe e inventarizuar depozitohet në arkiven e Drejtorisë.

30. Modelet e dokumentet e unifikuar (SDU_) që i bashkëngjiten kësaj rregulloreje, janë pjesë përbërëse e saj.



Datë ____ . ____ . ____

Nr.Prot.....

MIRATOHET

Drejtori i Drejtorisë

PROGRAM KONTROLLI

NË

(Emërtimi i plotë i subjektit të kontrollit)

Vendndodhja - Rrethi apo Qytetit

Objekti i kontrollit: *(Titulli i plotë).*

Lloji i kontrollit:

Subjekti apo Subjektet e kontrollit: *(Emërtimi i plotë)*

Metoda e kontrollit: *(Kontroll i njëpasnjeshëm dhe me zgjedhje, etj)*

Periudha e kontrollit: *(Periudha e veprimtarisë që kontrollohet)*

Afati i kontrollit: *(Nga data ____ deri më ____)*

Grupi i kontrollit: *(Emrat dhe mbiemrat e kontrollorëve, cilësuar përgjegjësin e grupit të kontrollit)*

Dokumentimi i rezultateve të kontrollit: *(Në përfundim të kontrollit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, procesverbaleve, aktverifikimeve dhe shqyrtimit të shpjegimeve të subjektit të kontrolluar, do të përgatitet Projektraporti i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit dhe rekomandimeve)*

Baza Ligjore: *Legjislacioni përkatës në fuqi, dhe kontratat dypaleshe respektive.*

DREJTIMET KRYESORE TE KONTROLLIT :

(Të ndara me çeshtje dhe nënçeshtje)

- 1.....
- 2.....
- 3.....
- 4.....etj.,



DEKLARATA E PAVARËSISË

DEKLARATË

Unë i nënshkruari _____ me detyrë Specialist _____ në _____ i caktuar në kontrollin e spitalit _____ me programin e kontrollit, Nr. __ Prot, datë ____ deklaroj se mospajtimet me subjektin e kontrolluar janë si më poshtë:

MOSPajTIMET NE LIDHJE ME SUBJEKTIN E KONTROLLUAR

1. Keni ndonjë lidhje financiare me ndonjë person i cili mund të kufizojë hapësirat ose të dobësojë kontrollin ?

2. Keni ndonjë paragjykim kundrejt ndonjë personi i cili me autoritetin e tij ose mënyra të tjera mund të influencojë opinionet tuaja ?

3. Keni pasur detyra drejtuese ose jeni përfshirë në mënyra të ndryshme në veprimtarinë e subjektit të kontrolluar gjatë tre viteve të fundit ?

4. A keni qenë i përfshirë në përpunimin ose zbatimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm ose në elemente të vecanta te tij ?

5. A jeni bashkëshort/bashkeshorte ose i afërm deri në tri breza me drejtuesit e subjektit, anëtarët e bordit dhe drejtorët e departamenteve ?

6. A keni ndonjë lidhje politike, shoqërore ose miqësore me anëtarët e bordit të drejtorisë apo drejtuesit e departamenteve ?

7. A keni qenë i punësuar gjatë tre viteve të fundit në subjektin në mënyrë të plotë apo të pjesshme, apo keni kryer shërbime për llogari të tij ?

8. A keni direkt ose indirekt ndonjë interes financiar me subjektin ?

Nëse gjatë kontrollit mund të shfaqet ndonjë mospajtim që nuk është deklaruar më sipër, ose mospajtime të tjera do të njoftoj menjëherë drejtuesin e njësisë së kontrollit.

Emri e mbiemri i specialistit te kontrollit

(_____)

Shënime për mundësinë e zvogëlimit të mospajtimeve, nëse ka të tilla:

PO	JO
PO	JO
PO	JO
PO	JO
PO	JO
PO	JO
PO	JO
PO	JO
PO	JO

Drejtori i Drejtorisë



Datë ____ . ____ . ____

Nr.Prot.....

Lënda: Njoftim për fillim kontrolli.

Zotit /Zonjës _____
Drejtor/e (emërtimi i plotë i subjektit që kontrollohet).

Vendndodhja - RRETHI apo QYTETI

Drejtorja e _____ do të fillojë kontrollin në *(emërtimi i plotë i subjektit)*, me objekt "Mbi *(sic është theksuar në programin e kontrollit)*, përfshirë periudhën që do t'i nënshtrohet kontrollit".

Bazuar në të Ligjit Nr.10 383, datë 24.2.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kontratës dypalëshe, etj. Kërkojmë të kontaktojmë me ju, për të prezantuar specialistet e kontrollit që do të ushtrojnë kontroll dhe për të mundësuar plotësimin nga ana e juaj për sa më poshtë:

1. Vënien në dispozicion të specialisteve të kontrollit të gjithë dokumentacionit që lidhet me objektin e kontrollit.
2. Dhënien e një ambjenti deri në perfundim të kontrollit me pajisjet e nevojshme për punë normale.
3. Programi me drejtimet e kontrollit do të paraqiten ditën e fillimit të kontrollit,

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

Drejtor i Drejtorisë

(Dokumenti i Unifikuar S DU.4)

Nr.Prot.....

Datë.....

Takimi fillestar i grupit të kontrollit me subjektin_____

Sipas njoftimit për fillimin e kontrollit me nr. _____ prot. datë_____, sot më datë_____ në subjektin _____ u realizua takimi fillestar.

Axhenda e takimit ishte:

- Prezantimi i grupit të kontrollit;
- Pershkrimi i objektit dhe objektivave të kontrollit;
- Njohja me programin e kontrollit;
- Mënyra dhe linjat e komunikimit midis grupit dhe stafit të subjektit;
- Shkëmbimi i adresave të e-mail-ve dhe nr .tel;
- Komunikimi midis grupit të kontrollit dhe stafit;
- Përcaktimi i informacionit dhe dokumentacionit që kërkohet nga grupi i kontrollit;
- Rënia dakord për kushtet e punës;
- Konfirmimi i afateve për realizimin e misionit të kontrollit;
- Te tjera (te ndryshme).

Për subjektin_____

Grupi i kontrollit

AKTVERIFIKIMI NR. _____

I mbajtur sot më datë _____, nga Specialist e kontrollit (emrat përkates të kontrollorëve), në (shënohet emërtimi i plotë i subjektit të kontrollit), me (emrat përkates të subjektit) me detyrë (shënohet e plotë detyra që ka sipas organikës, Drejtor i Spitalit shef pavioni, K/Dege, financier, magazinjer, etj.), mbi kontrollin e kryer për (shënohen qartë shkaku përse mbahet aktverifikimi dhe periudha që verifikohet sipas programit të kontrollit)

Nga kontrolli u konstatua se:

1. Në lidhje me; (përkruhen shkaqet një për një qartë, çfarë nuk është realizuar apo gjendja faktike, duke përcaktuar dispozitën ligjore apo nënligjore të pazbatuar).

2.....

3..... (dhe kështu me rradhë).

Për të metat e mangësitë e mësipërme (nëse ka) mbajnë përgjegjësi:

Z. apo Znj. _____

Z.apo Znj _____ etj. (pra, emri me të cilin apo të cilët mbahet aktverifikimi dhe që janë shkaktarë përgjegjës).

Përsa më sipër z. apo znj. _____ shpjegon se (shkruhet argumentimi i bërë apo arësyet e paraqitura). Në pamundësi të dhënies së argumentimeve, veprohet me marrjen e vërejtjeve bashkalidhur aktverifikimit, ose nënshkrimin e aktverifikimit nga personi përgjegjës pa vërejtje.

(Në Akt verifikim përkruhen në mënyrë të detajuar të gjitha pikat e programit për nën çështjen konkrete)

Ky aktverifikim mbahet në ____ (shifër dhe fjalë) kopje, nga të cilat ____ (shifër dhe fjalë) kopje i lihen institucionit, nga një kopje u jepet personave me të cilët është mbajtur dhe ____ (shifër dhe fjalë) kopje merren nga specialistet e Kontrollit.

(aktverifikimi mbahet në vend me personat përgjegjës lihet në protokollin e spitalit për tu nënshkruar me ose pa vërejtje).

- **Në bazë të Kontrates ne fuqi**", duhet të na ktheni 1 (një) kopje të nënshkruar, së bashku me vërejtjet përkatëse nëse do te keni, brenda _____ diteve nga data e marrjes së këtij Aktverifikimi.

Nëse nuk paraqisni dokumente apo prova të reja dhe nuk ktheni përgjigje në afat, problemet e trajtuara në Aktverifikim konsiderohen të mirëqëna.

**Emri mbiemri i personit
përgjegjës të subjektit**

Specialistet e kontrollit

PROCESVERBALI NR. _____

I mbajtur sot më datë _____, i mbajtur sot më datë _____, nga Specialist e kontrollit (emrat përkatës të kontrollorëve), në (shënohet emërtimi i plotë i subjektit të kontrollit), me (shënohen emrat një për një), me detyrë (shënohet e plotë detyra që ka sipas organikës, Drejtor Spitali, Zv/Drejtor, Shef Klinike, financier, farmacist, mjek, magazinjer, etj.), mbi kontrollin e kryer për (shënohen qartë shkaku përse mbahet procesverbali)

Nga kontrolli u konstatua se:

1. Në lidhje me _____ (përshkruhen shkaqet një për një qartë, duke përcaktuar dispozitën ligjore apo nënligjore që është shkelur), (p.sh. ligji nr. _____, datë _____, pika _____, gërma _____ etj; vendimi i Këshillit Ministrave nr. _____, datë _____, pika _____, Kontraten S/200_, neni _____, pika _____, dhe çdo bazë ligjore që atakohet etj).

Më poshtë vazhdohet

"Këto veprime të cilat janë në kundërshtim me nenin _____, të ligjit _____; pikës _____ të vendimit të KM, udhëzimit, rregullores, Kontrates, (duke shënuar emërtimin e saktë të dispozitës), i cili thote; (shkruhet qarte citimi i dispozites) kanë sjellë një dëm ekonomik prej _____ lekë (ose pasoja të tjera sipas konstatimit).

2.....

3..... dhe kështu me rradhë.

Për shkeljet e cilësuar më sipër mbajnë përgjegjësi:

Z. apo Znj. _____

Z.apo Znj _____ etj. (*pra, emri me të cilin apo të cilët mbahet proces-verbali dhe që jane shkaktarë përgjegjës*).

Ky procesverbal mbahet në (shifër dhe fjalë) kopje, nga të cilat _____ kopje (shifër dhe fjalë) kopje i lihen institucionit, nga një kopje u jepet personave me të cilët është mbajtur dhe (shifër dhe fjalë) kopje merren nga specialistët e Kontrollit.

Si rregull, procesverbali mbahet në vend me personat përgjegjës lihet në protokollin e spitalit për tu nënshkruar me ose pa verejtje.

- **Në bazë të Kontrates ne fuqi**, duhet të na ktheni 1 (një) kopje të nënshkruar, së bashku me verejtjet përkatëse nëse do te keni, brenda 5 (pesë) diteve nga data e marrjes së këtij procesverbali.

Nëse nuk paraqisni dokumente apo prova të reja dhe nuk ktheni përgjigje në afat, problemet e trajtuara në procesverbal konsiderohen të mirëqëna.

**Emri mbiemri i personit
përgjegjes të subjektit**

Specialistet e kontrollit

Shënim:

Do të mbahet procesverbal në të gjitha rastet kur konstatohen dëme ekonomike dhe shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, të cilat konsiderohen kundërvajtje administrative apo përbëjnë vepër penale. Në rastet e tjera sipas gjykimit mund të mbahen aktverifikimi.

(Dokumenti i Unifikuar S DU.7)

Nr ____ Prot.

Datë. ____/____/____

Mbi realizimin e takimit përmbyllës të kontrollit të ushtruar në _____

Sot më datë ____ . ____ . ____ në subjektin _____ u realizua takimi përmbyllës për kontrollin e kryer nga data ____ . ____ . ____ deri më ____ . ____ . ____

Axhenta e takimit ishte:

Paraqitja e aktverifikimeve dhe procesverbaleve;

Pyetje dhe diskutime rreth gjetjeve;

Shpjegime nga specialistet e kontrollit;

Rënie dakord për disa çështje të hasura gjatë kontrolli;

Të tjera (*shtohen diskutimet e tjera të realizuara gjatë takimit përmbyllës*).

Per subjektin _____

Grupi i kontrollit



PROJEKTRAPORT PËR KONTROLLIN E USHTRUAR NË

I përgatitur në datën ____ . ____ . ____

Kontrolli është realizuar në bazë të programit të Kontrollit të miratuar nga Drejtori i Drejtorisë me nr.prot..... datë. ____ . ____ . ____

Kontrolli është kryer nga specialistet e kontrollit :

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____

(kontrollorët sipas programit të kontrollit),

Në subjektin *(emërtimi i plotë i subjektit të kontrolluar)*, përfaqësuar nga z. _____, *me detyrë (drejtor spitali)-(ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij)*,

Kontrolli u ushtrua nga data ____ . ____ . ____ deri më datën ____ *(shënohen datat kur fillon dhe mbaron kontrolli në subjekt sipas përcaktimit në program)*.

PËRMBAJTJA

Përmbledhje ekzekutive.....	faqe.....
Hyrje.....	faqe.....
Metodat e Kontrollit.....	faqe.....
Gjetjet dhe konkluzionet (rezultatet e Kontrollit)... 	faqe.....
Rekomandime paraprake.....	faqe.....

Përmbledhje ekzekutive.(Kapitulli i I-rë i projektraportit)

Pjesa e parë (pjesa prezantuese)

Drejtortoria e _____ ushtroi kontroll në subjektin _____ për periudhën _____.

Çështjet e Kontrolluara:

Trajtohen të gjitha pikat e programit sipas çështjeve dhe nënçështjeve në rënd kronologjik.

Objektivat e Kontrollit. *Zbatimi i ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe vlersues.*

Metodat e kontrollit: *Kontroll i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e kontrollit.*

Konkluzionet (rezultatet e kontrollit)

Gjatë kontrollit të kryer duke verifikuar sipas rastit dokumentacionin (e plotë apo me zgjedhje) që ju vu në dispozicion grupit të kontrollit rezultoj se: *(Jepet vlersimi pozitiv për punën e mirë të bërë për ato drejtime ku vertetë ka rezultuar të jetë e mirë)*

Perveç vlersimit të punës së mirë, nga kontrolli i kryer rezultuan dhe mangësitë si më poshtë: *(Cdo mangësi trajtohet në mënyrë të përmbledhur në paragrafin e vet. Secila mangësi trajtohet duke e ballafaquar me dispoziten ligjore që ka atakuar).*

Rekomandimet paraprake

Nisur nga zbulimet e gjetura nga ky auditim, po paraqesim disa rekomandime kryesore:

Masat organizative.

(Cdo rekomandim trajtohet në dy paragrafe. Fillimisht cilesohet problemi i konstatuar ku thuhet trajtuar në faqet nr.....te projektraportit, si dhe baza ligjore e trajtimit. Paragrafi tjetër përshkruan rekomandimin e dhënë).

Masa zhdëmtuese

(Për cdo rast në një paragraf jepet vlera e dëmit që duhet cëmtuar, personi që duhet ta zhdëmtojë. Paragrafi mbyllet me fjalinë "Trajtuar më hollësisht në faqet _____ të projektraportit")

Hyrje (Kapitulli i II-të i projekt raportit)

(Hyrja jep në mënyrë të përmbledhur historikun e kontrollit, puna që është bërë si dhe arsyet, bashkëpunimin me subjektin e kontrolluar. Në paragrafin e fundit theksohet zbatimi i standarteve. Duhet të shmangen informacionet e tepërta).

(Kontrollit u krye për zbatimin e ligjshmerise gjate aktivitetit ekonomik financiar tekniko mjeksor Per realizimin e kontrollit jemi mbeshtetur ne dokumentacionin e vënë në dispozicion, i cili u verifikua sipas rastit në mënyrë të plotë ose me zgjedhje. Pervec kontrollit te dokumentacionit jemi bazuar ne këshillimin dhe ballafaqimet me punonjësit e subjektit të kontrolluar. E gjithë praktika e kontrollit u krye duke patur si qellim realizimin e objektivit të kintrollit, dhënjën e nje opinionit të saktë për identifikimin dhe trajtimin e risqeve, realizimin e objektivave ne perputhje me ligjet duke perdorur fondet e e financuara nga Fondi me ekonomi, efektivitet dhe eficence).

Vlersojmë bashkëpunimin dhe diskutimet e vleshme me specialistet dhe drejtuesit e subjektit Sptalor _____ , bashkëpunim i cili bëri më efektiv realizimin e programit të Kontrollit.

Në perfundim të Kontrollit me personat përgjegjes u hartuan akt verifikemet, proces verbalet e duhura të cilat u protokolluan në subjekt dhe u lanë për tu dërguar të nënshkruara me ose pa verejtje . Subjekti i kontrolluar ka dërguar dokumentacionin me shkresën nr. ___ datë _____.

Pasi u shqyrtuan verejtjet dhe shpjegimet e ketyre punonjësve, u morën në konsideratë ato observime që ishin bindëse dhe kishin bazë ligjore. Të cilat u trajtuan në një aneks të veçantë të projektraportit. Mbi këtë bazë u pergatit Projektraporti .

Gjatë ushtrimit të kontrollit dhe formulimit të këtij raporti grupi i kontrollit ka zbatuar Kodin Etik dhe Standartet e Miratuara të kontrollit.

Metodat e kontrollit. (Kapitulli i III-të i Projektraportit)

(Këtu trajtohet si e ka bërë punën kontrolluesit, periudha e mbulimit ,metodologjia e perdorur)

Gjetjet dhe konkluzionet (Kapitulli i IV i Projektraportit).

Në këtë kapitull trajtohen radhazi te gjitha pikat dhe nënpikat e programit. Gjetjet trajtohen sipas seksioneve gjate hartimit te programit. Duhet te theksohet per cdo gjetje se cfar e ka shkaktuar problemin (mungesa e kontrollit te brendshëm,ndarja e dobët e përgjegjësive apo paaftesia profesioanle dhe mungesa e trajnimeve), shuma e perfshirë ne këtë gjetje, dispozita ligjore e atakuar si dhe cfar duhet permisuar në të ardhmen. Gjetjet duhet te mbeshtetten me te dhena. Edhe vlersimet pozitive duhet te mbeshteten me të dhëna. Per rastet e dhenjes se opinioneve pozitive të dhënat duhet te jenë në masen sa per te mbeshtetur opinionin. Në këtë kapitull në një aneks të vecantë trajtohen dhe observacionet e bëra nga subjekti i kontrolluar dhe përgjigjet e dhëna për to.

Rekomandimet paraprake (kapitulli i V-të i Projektraportit)

Në përfundim të kapitullit “Gjetjet dhe konkluzionet” shkruhet afersisht keshtu : Për permisimin e punes mendojme të ju dergojmë keto rekomandime ,te cilat duhet ti shikoni me vemendje dhe jemi te hapur per mendimet e verejtjet tuaja në sherbim të permisimit të punes në të ardhmen.

Pastaj fillohet me rekomandimet.

Edhe në këtë pjesë të raportit ato trajtohen si dhe te permbledhja ekzekutive. Fillohet me masat organizative dhe vazhdohet me ato cdemtuese.

Cdo rekomandim trajohet ne dy paragrafe. Fillimisht cilesohet problemi i konstatuar ku thuhet trajtuar ne faqet nr.....te projektraportit, si dhe baza ligjore e trajtimit. Paragrafi tjetër pershkruan rekomandimin e dhënë.

Projektraporti mbyllet si më poshtë:

Të gjithë punonjësve që atakohen në këtë Projektraport kontrolli duhet t’u bëhen prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t’u jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe bëjnë verejtje nëse kanë.

Pjesë përbërëse e këtij Projektraporti jane edhe dokumentacioni i mbajtur, si më poshtë:

13. Procesverbali nr. 1, për.....

14. Procesverbali nr. 2, për.....dhe me rradhë.

15. Aktverifikimi nr. 1, për
16. Aktverifikimi nr. 2, për*dhe me rradhë.*

Në fund të atkcontroollit shkruhet:

“Përsa më sipër paraqitet ky Projektraport Kontrolli”.

Për (*emërtimi subjektit kontrolluar*)
Emëri i titullarit, personit të
autorizuar, e ndonjë tjetër.

Specialistet e Kontrollit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Datë ____ . ____ . ____

Nr.Prot.....

Lenda: Dërgohet Projekt Raport Kontrolli

Z/Zj. _____ Drejtor /e i/e (*emërtimi i plotë i subjektit që është kontrolluar*).

Vendndodhja-**RRETHI apo QYTETI**

Bashkëlidhur ju dërgojmë 2 (dy) kopje të "Projekt raportit të kontrollit" mbi kontrollin e ushtruar në (*emërtimi i subjektit që kontrollohet*) me objekt "Mbi(*sipas emërtimit në programin e kontrollit*)".

Bazuar në _____ Vendoset baza ligjore e referimit) _____, **brenda 10 (dhjetë) diteve** nga dita e marrjes së kësaj shkrese, duhet të na ktheni 1 (një) kopje të "Projektraportit", të nënshkruar e të vulosur nga ana juaj ose në mungesë tuaj nga personi i autorizuar, (të shoqëruar me ose pa vërejtje), në të kundert Projektraporti i kontrollit do të konsiderohet i mirëqenë dhe do të hartohen "Konkluzionet e kontrollit".

Duke Ju faleminderuar për mirëkuptimin.

Drejtori i Drejtorisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Datë ____ . ____ . ____

Nr.Prot.....

V E N D I M

Nr. _____, Datë _____

MBIKONTROLLIN E USHTRUAR NË _____

Z/Zj. _____

Drejtor/e i/e (Shënohet emri i subjektit)

Vendndodhja _____

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Kontrollit të paraqitur nga grupi i kontrollit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i kontrolluar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e kontrollit, në mbështetje të _____ (Shënohet baza ligjore)

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Kontrollit “Për ..objekti i kontrollit i plotë” të ushtruar në(emërtimi i subjektit të kontrolluar).

II. Të miratoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË UDHËZIME APO RREGULLOREN NË FUQI (*shkrimi me gërma kapitale, 14 dhe bold*).

1. Nga kontrolli i zbatimit të ligjit (vendimit, udhëzimit, etj.) ka rezultuar(*shtjellohen mangësitë apo hapësirat që kanë ardhur si pasojë e zbatimit korrekt të këtij apo atij akti*) dhe vijohet me propozimet për ndryshim apo përmirësim.

2.....etj. (*nëse ka*)

B. MASA ORGANIZATIVE (gërma kapitale, numër 14, bold)

1. Të merren masa për ..(jepet detyra sipas përkatësisë)

2.

3. etj.

Këto masa mundësisht të jenë me afate, ose në varësi të gjykimit të shënohet "Vazhdimisht", "Menjëherë" e ndonjë tjetër.

C. MASA ZHDËMTIMI

Të bëhen kontabilizimet për ____ persona në vlerën ____ lekë dhe të ndiqet rruga ligjore për arkëtimin e vlerës si më poshtë:

- për ____ persona në vlerën ____ lekë për _____;

- për ____ persona në vlerën ____ lekë për _____.

etj.

Këto masa të jenë me afate, ose në varësi të gjykimit të shënohet "Menjëherë".

D. MASA ADMINISTRATIVE

a) Mbështetur në Kontraten me spitalin, ose ne ligjin per kundravajtjen administrative, etj..., kërkojmë të ndëshkohen për kundërvajtje administrative në shumën ____ lekë apo ____ lekë punonjësit si më poshtë:

1. _____

2. _____

3. _____ etj

Për shkeljen e detyrimeve kontratuale, neni..... pika..... shkruhet paragrafi i plote;

Për shkeljet e konstatuara në mbajtjen e kontabilitetit, mbështetur në _____, kërkojmë të ndëshkohen me gjobë ____ punonjës, si më poshtë:

1. Z/Znj _____ me detyrë _____, pasi:

(Shënohen mangësitë e hasura gjatë kontrollit)

etj.

E. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në kontraten me spitalin, neni....pika.....

kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

(Përshkruhen llojet e masave Disiplinore sipas percaktimeve ligjore)

F. KUSHTE PENALE

Bazuar ne kontraten me spitalin, neni _____, pika, paragrafi i plote, te merren masat për vendosjen e kushtit penal, per personat si me poshte:

1.

2.

Per shkeljen e konstuar si me poshte.....

Nëse nga grupet e kontrollit në vlerësimin e veprimtarisë së spitalit të kontrolluar evidentohen **elementë të veprave penale**, atëhere shtohet një kapitull me emërtimin “**KALLZIM PENAL**”.

Për masat e marra të njoftohet Struktura (drejtoria / sektor) e Kontrollit Spitalor **brenda 20 ditëve** nga marrja e kësaj kërkesë.

Drejtore i Drejtorisë

EVIDENCA E KONTROLLIT

Emertimi i Subjektit te Kontrolluar (Spitali) _____

Kohezgjatja e kontrollit: nga data _____ deri ne daten _____

Nr .	Shkeljet e konstatuara	Masa organizative	Masat disiplinore	Masat administrative (gjoba)	Masat detyrim per shperblim demi	Kushte penale	Nderprerje kontrate	shenime

Grupi i Kontrollit:



VLERËSIMI I CILËSISË SË KONTROLLIT

Subjekti i kontrolluar: _____
Lloji i kontrollit _____
Grupi i kontrollit _____
Afati i kontrollit në ditë pune (Plan) _____
Afati i kontrollit në ditë pune (Fakt) _____
Risku i kontrollit _____
Realizimi i detyrave të Programit të Kontrollit _____
Çështjet e lëna pa kontrolluar nga Programi _____
Kosto e kontrollit (ditë – njerëz në plan) _____
Kosto e kontrollit (ditë – njerëz në fakt) _____
Evidenca e kontrollit e plotësuar _____
Qartësia dhe konciziteti i raportimit të kontrollit _____
Zbatimi i standarteve të kontrollit _____
Zbatimi i kodit etik _____
Zbatimi i detyrave nga ekspertët e aktivizuar _____
Argumentimi ligjor i shkeljeve _____
Konstatimet e dëmeve gjithsej në vlerë _____
Rekomanduar për t'u arkëtuar _____
Arkëtuar gjatë procesit të kontrollit _____
Ballafaqimet e kryera _____
Propozime për ndryshim apo përmirësim legjislativ në numër _____
Masat e zhdëmtimit të propozuara në vlerë _____
Masat administrative të propozuara në persona e vlerë _____
Masa disiplinore të propozuara në numër _____
Nga këto: Largim nga puna ose detyra _____
Kallëzime penale në numër (çështje) _____
Personat e kallëzuar në numër _____

Drejtori i Drejtorisë

Fletë Inventari

Inventari i Dosjes Nr. _____, per kontrollin e ushtruar në Subjektin:

Spitali _____

Periudha e kontrolluar: (_____)

Afati i kryerjes se kontrollit: Nga data _____ deri më _____

Grupi i Kontrollit:

Nr.	Emertimi i shkreses	Nr. date	Nr.i fleteve
1.	Njoftim per fillimin e kontrollit		1
2	Program i kontrollit		3
3.	Akt-verfikime	
4.		
5.	Procesverbale		
	Projekt-raporti i kontrollit		
6.	Shkresa per dergimin e projekt-raportit		
	Raporti i Kontrollit		
7.	Projekt-vendimi		
8.	Vendimi		
9.	Shkresa per masat dhe rekomandimet		
10.	Dokumentacioni ndihmes,		
11. Etj.....		
		
	TOTALI I FLETEVE	

Inventari perfundon me numer rendor _____

Grupi i Kontrollit

1.

2.

3.

Dorëzuesi (Përgjegjësi i Grupit)

Marresi ne dorezim

Data, me ___/___/___

DOSJA NR____ (numër i madh)

Viti 200_

TITULLI :

PËR

KONTROLLIN E USHTRUAR NË (*emërtimin e subjektit*) **PËR** (*tematika e kontrollit*).

Afati i ruajtjes_____

Sasia e fletëve_____

Ka filluar më_____

Ka mbaruar më_____

Regjistruar në inventarin e dosjeve
me numër rendor_____